



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:042580

Datë: 27.05.2022

Numri i dokumentit: 03065551

DKR.nr.67/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale, kundër të akuzuarit F. B. nga Peja, për shkak të kryerjes së veprës penale “*Blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge*” nga neni 267 par. 1 të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.83/2022 të datës 14.04.2022, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar me datë 29.04.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani, të akuzuarit F. B. dhe mbrojtësit të tij, av. M. I. sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, me dt. 27.05.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. B. i biri i F. dhe nënës L. e gjinisë L. i lindur me dt. në Pejë ku edhe banon në rr. nr. ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion tregtar i veturave, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr. personal posedon nr. të telefonit shqiptar, shtetas i Rep. Së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit nga dt. 02.03.2022 e deri me dt. 29.04.2022, ndërsa tani është në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Nga data e pacaktuar e deri me dt.02.03.2022, rreth orës 07,30 minuta në mënyrë të paautorizuar e me qëllim të shpërndarjes dhe të shitjes ka poseduar substancë narkotike të llojit kokaine në peshë neto prej 1.001,6 gram e i cili narkotik ishte sekuestruar nga i pandehuri F. me dt.02.03.2022 në Lagjen D. në P., në afërsi të udhëkryqit të rrugës- P., ku i pandehuri së bashku me D. G. rreth orës 07,30 minuta janë hasur nga Policia duke kërkuar diç nëpër mëgje

me çrast D. iu ka thënë Policëve se po kërkojnë disa fishekë që i kishte hedhur aty natën rreth orës 01,00 pasi që Policia kishte ndaluar për kontroll fillimisht të pandehurin F. i cili ishte me veturë P. dhe pasi F. ishte larguar pas kontrollit Policia ka ndaluar edhe D. G. dhe pasi kishte filluar kontrollin D. me çrast i sekuestrohet edhe një pistoletë dhe në mëngjes rreth orës 05,00 i pandehuri F. e thërret D. që së bashku të shkojnë në vendin e ngjarjes duke i thënë se kinse natën ka humbur një pako me fishekë në vendin e lartcekur dhe kur D. shkon në vendin e ngjarjes takon F. duke kërkuar kinse fishekë e që për qëllim kishte për të marrë narkotikun të cilin e kishte hedhur F. natën kritike nga vetura pasi kishte vërejtur Policinë me çrast nga ana e Policëve në afërsi të pandehurit F. dhe D. është gjetur një pako e mbështjelle me izolir ngjyrë hiri e cila në brendi kishte narkotik të llojit kokain në peshë prej 1001.6 gram e e cila sekuestrohet nga ana e Policëve,

-me çka ka kryer vepër penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në nga neni 267 par.1 të KPRK-së,

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39 par.1 nën par. 1.1 dhe 1.3, 40 par. 1 pika 1.2 dhe pika 1.3 69 par.1 pika 3.6 dhe 3.7, 267 par.1 dhe par. 5 të KPRK-së, si dhe nenit, 360, 365, 366, 450 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së, e po ashtu 233 të KPPRK-së në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë nën shenjen, PP/I Nr. 83/2022 të dt. 14.04.2022 të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Me **dënim burgimi** në kohëzgjatje prej 21 (njëzetë e një) muaj, e të cilin dënim i pandehuri, do ta mbaje pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim, do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, dhe atë nga dt. 02.03.2022, e deri me 29.04.2022.
- II. Me **dënim me gjobë** në shume prej 3000 (tre mije) euro, e të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaje në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i pandehuri refuzon, apo dështon ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi, duke i llogaritur një ditë burgimi shumë 20 euro.
- IV. Të pandehurit F. B, në kuptim të nenit 367 par. 1, pika 1.2 e lidhur me par. 3, të KPPRK-së, i është ndërprere paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit.
- V. Obligohet, i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

VI. Në kuptim të nenit 267 par. 5, të KPRK-së, ndaj të pandehurit F. B. i shqiptohet:
DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET substanca narkotike e llojit kokain e sekuestruar nga i pandehuri F.B në peshë të përgjithshme prej 1.001,6 gram.

URDHËROHET substanca narkotike e llojit kokain e sekuestruar nga i pandehuri F. B. në peshë të përgjithshme prej 1001,6 gram pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

VII. Në kuptim të nenit 115 par. 2, nenit 274 e lidhur me nenin 273 të KPPRK-së, ndaj të pandehurit F.B i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET shuma e të hollave të sekuestruar përkohësisht nga i pandehuri F. B. në shumë të përgjithshme prej 700 (shtatëqind) euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me datën 14.04.2022 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 83/2022 kundër të pandehurit F. B. për shkak të veprës penale “*Blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge*” nga neni 267 par. 1 të KPPK-së.

Bashkë me aktakuzën, prokuroria i ka dërguar gjykatës edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, mes Prokurorisë dhe të pandehurit F. B. se bashku me mbrojtësin të tij, av. Muhamet Ibraj sipas autorizimit me dt. 12.04.2022.

Gjykata me datën 29.04.2022, ka caktuar dhe mbajtur seancën, për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent kane qene Prokurori i Shtetit Agron Galani, i pandehuri F. B. si dhe mbrojtësi i tij, av. M. I. sipas autorizimit.

Në kuptim të nenit 233 par.18, të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues ka dëgjuar të pandehurin dhe ka vërtetuar se, i pandehuri, e ka kuptuar natyrën e veprës penale e cila i është vënë në barrë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të paraqitura në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhje të akuzës që parashihet me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPPRK-së. Në kuptim të nenit 233 par.19, të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues ka dëgjuar pikëpamjet të Prokurores së Shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të pandehurit.

Prokurori i Shtetit, në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë deklaroi se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, te bërë sipas kushteve të marrëveshjes pasi që i pandehuri i ka kuptuar pasojat dhe natyrën e veprës penale, pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, si dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, të caktuar sipas detyrës zyrtare, si dhe te gjitha pikat e aktakuzës te cilët i vihen ne barre.

Po ashtu, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kanë deklaruar se mbeten në tërësi, pranë marrëveshjes së arritur për pranimin e fajësisë me Prokurorin e Shtetit.

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sipas nenit 247 par 1, lidhur me nenin 233 par. 18 të KPP-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij. dhe se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253 par. 1 dhe 2, të KPP-së.

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 233 par. 18 i KPP-së, andaj ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin e lartë cekur, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1, të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese, mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, i njëjti ka pohuar se ndjen keqardhje, faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, si dhe pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 21 (njëzetënjë) muaj u morr konform nenit 42 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë u morr konform nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim burgimi në rast se i pandehuri nuk e paguan. Dështon apo refuzon ta paguaje dënimin e shqiptuar me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3, të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 367 par. 1 pika 1.2 e lidhur me par. 3, të KPPRK-së, të pandehurit i është ndërprere paraburgimi pas shpalljes se aktgjykimit, e qe për këtë gjykata ka sjellë Aktvendim të veçantë pas shpalljes dhe atë me dt.29.04.2022, nënë shenjen e numrit të lëndës PKR.nr.67/22.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për konfiskim të substancës narkotike, u morr konform nenit 267 par. 5 të KPPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e të hollave të sekuestruara përkohësisht nga i pandehuri F.B në shumë të përgjithshme prej 700 (shtatëqind) euro, u morr konform nenit 115 par. 2, nenit 274 e lidhur me nenin 273 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
DKR.nr.67/22 dt. 27.05.2022

Zyrtari ligjor
Alan Taranish

Kryetari i trupit gjyqësor,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

.

Numri i lëndës: 2022:042580
Datë: 27.05.2022
Numri i dokumentit: 03065551